29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

### **Neni 30 Shkaqet për kompensim**

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

## **PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET**

### **Neni 31 Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

### **Neni 32 Testet për përfundimin**

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm**.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose

- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

#### **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose  
b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose  
b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

#### **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

#### **Shkelja e kontratës dhe shkëputja**

##### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose  
b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëshmipërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrimi;
- d. PAGESA E VËRTETUAR nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "**Force Madhore**" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësitë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39           Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40           Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41           Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

### **Neni 42           Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përqipen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43           Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

**E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>gjuha Shqipe</b> .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është <b>3,889.10 euro me vlefshmëri prej 120 ditë</b> .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda <b>5 ditë</b> kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është <b>15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit</b> .

Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë <b>15 dite pas nënshkrimit të kontratës.</b>
Periudha e ekzekutimit	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <b>90 ditë</b> kalendarike.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <b>0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës</b> për ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është <b>10%</b> e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	<b>Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,</b>
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës
Pagesa	24	Autoriteti Kontraktues do të paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në disa situacione <b>për punët e kryera dhe të konstatuara nga menaxheri i kontratës.</b>
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <b>nuk ka pagese paraprake</b>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <b>10% i vlerës së kontratës.</b>  Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda <b>30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK.</b>  Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".  <b>Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve 3 vite.</b>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <b>15 ditë</b> kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është <b>3 vite</b>
Pagesa shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <b>përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.</b>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<b>Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e

<p>me procedurë gjyqësore</p>		<p>mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë</b> në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <b>Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës</b> në kuadër të <b>Odës Ekonomike të Kosovës</b>, në përputhje me rregullat e <b>Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë</b>.</p> <p><b>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</b></p>
-------------------------------	--	---



PARAMASA DHE PARALLOGARIA							
ÇERDHE-KOPSHI "SHTËPIA MAGJIKE" NË FSHATIN BESI - PRISHTINË							
Në shtim njësi duhet të parashihet lëvizja, furnizimi, punë/montimi i çdo materiali me pozicionim sipas projektit dhe testimi i materialeve para lëshuarës në punë. Sistemi i materialeve, postimi i punës nga mbeturinat gjatë dhe pas kryesjes së punimeve.							
Për të gjitha materialet dhe produkte ndërtimore që përdoren, paraprakisht të ofrohen certifikatat mbi kualitetin e tyre të cekura edhe në pozicion.							
Materialet dhe produktet ndërtimore të përkshuara në pozicion, nuk duhet të ndryshohen apo zëvendësohen pa aprovim nga projektuesi.							
Pos	Përshkrimi	Njësia	Sish	cm/m <sup>2</sup> për njësi pa TVSH	TVSH për njësi	Çmimi për njësi me TVSH	€/Total
1	<b>PUNËT E DEMOLIMIT</b>						
Shënim: Për asnjë se ndërtesa ka do të rikonstruohet për çerdhe të të ndërtuesit ekzistues, duhet të organizohet nga investitori si "Njësi Ekektora" për të gjithë efektuesit në mënyrë që paraprakisht të bëhen punët përgatitore dhe të shkërcëhet shtesa edhe në ndërtuesit.							
1.1	Largimi, heqja dhe transporti i të gjitha lodrave dhe elementeve përcjellëse që gjenden brenda në oborr të çerdhes si dhe largimi i kubëzave të shtritura tek lodrat. Zhvendosja e tyre përcaktohet nga drejtoresha e çerdhes.	Pzshat	1	84.75 €	15.25 €	100.00 €	100.00 €
1.2	Demolimi i mureve të brendshme ekzistuese sipas pozicioneve të përkshuara në projektin e demolimit, si dhe transportimi i tyre deri në deponinë e caktuar nga organet mbikëqërëse. Llogaria në m <sup>2</sup> .	m <sup>2</sup>	60	0.85 €	0.15 €	1.00 €	60.00 €
1.3	Demolimi i pllakave në WC-të e fëmijëve dhe në kuzhinën ekzistuese, në dysheme dhe në mure si dhe një pjesë të koridorit që lidhet me WC-në e administratës me qëllim të kësaj së instalimave të ujit. Në pozicion përfshihet edhe transporti i tyre deri tek deponia e caktuar nga organet mbikëqërëse.	m <sup>2</sup>	55	0.85 €	0.15 €	1.00 €	55.00 €
1.4	Demolimi i themelit ekzistues të kalldtores mbrapa çerdhes me dimensione 350x355 cm dhe lartësi të përafërt h=80cm.	m <sup>3</sup>	3.5	0.85 €	0.15 €	1.00 €	3.50 €
1.5	Demolimi i shkallëve ekzistuese dhe gardhit anësor tek dalje emergjente e çerdhes në pjesën veriore.	m <sup>3</sup>	4	0.85 €	0.15 €	1.00 €	4.00 €
1.6	Demolimi i rampës ekzistuese nga beton armuar dhe gardhit anësor nga çeliku në hyrje të çerdhes.	m <sup>3</sup>	8	0.85 €	0.15 €	1.00 €	8.00 €
1.7	Demolimi i shtegut në hyrje të çerdhes dhe shtegut në oborr me të gjitha shtresat dhe transporti i tyre deri në deponinë e caktuar nga organet mbikëqërëse.	m <sup>2</sup>	50	0.85 €	0.15 €	1.00 €	50.00 €
1.8	Demolimi dhe largimi i dritares në pjesën perendimore me dimensione 180x140cm, si dhe demolimi i murit të parapetit, me qëllim të hapjes së derës. Në pozicion të parashihet edhe transportimi i saj deri në deponinë e caktuar nga organet mbikëqërëse.	Copë	2	0.85 €	0.15 €	1.00 €	2.00 €
1.9	Demolimi dhe largimi i dritareve në WC dhe lavanderin ekzistuese me dimensione të përafërta 80x50cm, demolimi i pjesës së murit nën dritaren ekzistuese dhe lënia e parapetit të njëjtë me parapetet e dritareve tjera ekzistuese. Në pozicion të parashihet edhe transporti i tyre deri në deponinë e caktuar nga organet mbikëqërëse.	Copë	2	0.85 €	0.15 €	1.00 €	2.00 €
1.11	Demolimi dhe largimi i derës për dalje emergjente me dimensione 80x210 cm dhe transportimi i saj deri në deponinë e caktuar nga organet mbikëqërëse.	Copë	1	0.85 €	0.15 €	1.00 €	1.00 €
1.12	Demolimi dhe largimi i dverve të hyrjes kryesore me dimensione të përafërta 210x180cm. Materiali duhet të transportohet deri në deponinë e caktuar nga organet mbikëqërëse. Llogaria në copë.	Copë	2	0.85 €	0.15 €	1.00 €	2.00 €
1.13	Demolimi, largimi dhe transporti i të gjitha dverve të brendshme deri në deponinë e caktuar nga organet mbikëqërëse. Llogaria në copë.	Copë	9	0.85 €	0.15 €	1.00 €	9.00 €
1.14	Demolimi dhe largimi i tregullave në kulmën e çerdhes ekzistuese së bashku me konstruksionin mbajtës ( me të gjitha elementet), me qëllim të lidhjes me kulmën e aneksit të shtuar, dhe transporti i saj deri në deponinë e caktuar nga organet mbikëqërëse. Llogaria në m <sup>3</sup> .	m <sup>3</sup>	50	0.85 €	0.15 €	1.00 €	50.00 €
1.15	Largimi i kulmit të ndërtuesit ekzistues (kalldtores) së bashku me konstruksionin mbajtës ( me të gjitha elementet) dhe transporti i saj deri në deponinë e caktuar nga organet mbikëqërëse. Llogaria në m <sup>3</sup> .	m <sup>3</sup>	15	0.85 €	0.15 €	1.00 €	15.00 €
1.16	Çmontimi i elementeve në WC-të e fëmijëve si dhe kuzhinës, në pozicion përfshihet heqja e të gjitha elementeve të cilat gjenden në hapësirat e WC-ve dhe kuzhinës, si dhe transportimi i tyre deri në deponinë e caktuar nga organet mbikëqërëse.	Copë	15	0.85 €	0.15 €	1.00 €	15.00 €
1.17	Demolimi i dyshemesë ekzistuese në hapësirën ku është paraparë të vendoset kuzhina e re, me qëllim të pllakosjes me pllaka të qeramikes si në dysheme ahtut edhe në muri. Në pozicion të parashihet transporti i materialit deri në deponinë e caktuar nga organet mbikëqërëse.	m <sup>3</sup>	30	0.85 €	0.15 €	1.00 €	30.00 €
1.18	Demolimi i sillobankut, ulluqera vertikale si dhe horizontale. Pozicioni përfshihet edhe transportin e tyre deri në deponinë e caktuar nga organet mbikëqërëse.	m <sup>3</sup>	60	0.85 €	0.15 €	1.00 €	60.00 €
1.19	Demolimi dhe zhvendosja e radiatorit tek dritarja e cila do të kthehet në derë për dalje në oborrë. Zhvendosja e radiatorit të bëhet në konsultim me organet mbikëqërëse, duke u përcjellë me të gjitha elementet përcjellëse në mënyrë që të jetë stabile dhe funksionale.	copë	1	0.85 €	0.15 €	1.00 €	1.00 €
		Total poz. 1					
2	<b>PUNËT PREGADITORE / PUNËT E DHEUT</b>						




2.2	Hegjja e dheut për hapjen e themeleve shiritore me gjërësi 60cm dhe thellësi 80cm, si dhe transporti i saj deri në deponinë e caktuar nga organet mbikëqërëse.	m <sup>3</sup>	28	0.85 €	0.15 €	1.00 €	28.00 €
Total poz. 2							28.00 €

<b>3 PUNËT E ZHAVORIT</b>							
3.1	Furnizimi, transporti dhe shtrurja e zhavorit në punë të me fraksion 0-31mm dhe 0-60mm dhe ngjësja e tij nën themelet e aneksit të shuar. Trashësia e zhavorit me të djatja shtrësat, duhet të jetë t=20cm dhe të ngjësht deri sa vlera e modulit të shafijës të arrijë vlerën f>=35MPa.	m <sup>3</sup>	8	5.93 €	1.07 €	7.00 €	56.00 €
3.2	Furnizimi, transporti dhe shtrurja e zhavorit-tamponit me fraksion 0-63mm dhe ngjësja e tij nën rampë të hyrjes dhe shkallëve për dalje në oborrë të çerdhës. Trashësia e zhavorit duhet të jetë 20 cm dhe të ngjësht deri sa vlera e modulit të shafijës të arrijë vlerën f>=35MPa.	m <sup>3</sup>	5	5.93 €	1.07 €	7.00 €	35.00 €
Total poz. 3							91.00 €

<b>4 PUNËT E BETONIT</b>							
<p>Per të gjitha elementet konstruktive është përcaktuar klasa e betonit C-25/30 kjo duke u mbështetur në kërkesat për qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi të betonit sipas Udhëzimit administrativ Nr.2008/22. Betonit dhe Konstruksionet e Betonit dhe SK EN 206-1:2002. Betonit - pjesë 1. Specifikimet, vetë, prodhimi dhe konformiteti (EN 206:2000). Për përgatitjen e betonit duhet të shfrytëzohet agregati i kushtetë të dëshmuar më parë nga paktësimi dhe përbërjes mineralogjike dhe petrografike. Karakteristikave mekanike etj. Agregati duhet të jetë i pasuruar dhe i separuar në katër (4) fraksione komformitetit të çelën e përgatitjes prodhuesit i betonit për të fuqur klasën e betonit të lartë cekur. Kualiteti i çimentos duhet të dëshmohet në mënyrë praktike, si dhe uji i çelës përdoret për përgatitjen e betonit duhet të jetë plotësisht i pastër. Betonit të përgatitjes në repote prodhuese - fibërë të betonit të të çelës është e konfiruar saktësisht e dozimit sipas recetivës të dëshmuar. Gjate betonimit dhe zbatimit të objektit, pune kryesit është i obliguar që të përmbahet të gjitha rregullave dhe standardeve në ndërtimtarit si dhe të përmbahet rregullave për mbrojtjen teknike në punë.</p>							
4.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja në vepër, kompaktimi dhe mirëmbajtja e betonit të armuar me klasë C25/30, i themeleve shiritore tek aneksi i shuar me thellësi të përafërt h=60cm.	m <sup>3</sup>	18	50.00 €	9.00 €	59.00 €	1,062.00 €
4.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja në vepër, kompaktimi dhe mirëmbajtja e betonit të armuar me klasë C25/30, betonimi i cokllës me lartësi të përafërt h=25cm.	m <sup>3</sup>	4	50.00 €	9.00 €	59.00 €	236.00 €
4.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja në vepër, kompaktimi dhe mirëmbajtja e betonit me klasë C25/30. Betonimi i pllakës nga BA e vendosur mbi themele me trashësi t=12cm.	m <sup>3</sup>	11	50.00 €	9.00 €	59.00 €	649.00 €
4.4	Furnizimi, transporti dhe vendosja në vepër, kompaktimi dhe mirëmbajtja e betonit me klasë C25/30. Betonimi i shyllave nga BA me dimensione 30x30x290cm	m <sup>3</sup>	3	50.00 €	9.00 €	59.00 €	177.00 €
4.5	Furnizimi, transporti dhe vendosja në vepër, kompaktimi dhe mirëmbajtja e betonit me klasë C25/30. Betonimi i pllakës meskatore nga BA, me trashësi të përafërt t= 12cm.	m <sup>3</sup>	17	50.00 €	9.00 €	59.00 €	1,003.00 €
4.6	Furnizimi me material si dhe punim i rampës në hyrje të çerdhës me beton armë. Gjërësia e rampës është përafërsisht 2.10m dhe përfshinë aktivitetet si vijon: - Gërmimi i themelet - Shtrurja e zhavorit t=20cm, - Kallupimi, armimi si dhe betonimi i themeleve - Kallupimi, armimi si dhe betonimi i mureve anësore t=15cm - Kallupimi, armimi si dhe betonimi i pllakës t=12cm	m <sup>3</sup>	15	50.00 €	9.00 €	59.00 €	885.00 €
4.7	Furnizimi, transporti dhe vendosja në vepër, kompaktimi dhe mirëmbajtja e betonit të armuar me klasë C25/30. Betonimi i shkallëve nga BA. Gjërësia e shkallëve është përafërsisht 1.50m dhe përfshinë aktivitetet si vijon: - Gërmimi i themelet - Shtrurja e zhavorit t=20cm - Kallupimi, armimi si dhe betonimi i themeleve - Kallupimi, armimi si dhe betonimi i murit anësore t=15cm - Kallupimi, armimi si dhe betonimi i shkallëve t=12cm	m <sup>3</sup>	3	50.00 €	9.00 €	59.00 €	177.00 €

<b>5 PUNËT E MURATIMIT</b>							
5.1	Furnizimi, transporti dhe muratimi i mureve me blloqe gjer me dimensione 20 x 25 x 20cm, me peshë 6.2kg. Blloqet me standarde të kualitetit sipas EN-ISO 9001. Muratimi punohet me llaç shtrësëhollë: Rërë, Çimento. Në çrëmitë të llogaritë lidhja vertikale në shylla dhe horizontale në tavane me shkumë mbushëse (propen) dhe të gjitha punët e nevojshëm për këtë pozicion, vendosen sipas pozicioneve në projekt.	m <sup>2</sup>	150	8.47 €	1.53 €	10.00 €	1,500.00 €
5.2	Furnizimi dhe muratimi i mureve me blloqe gjer 12x25x20cm, 6.2 kg. Blloqet me standarde të kualitetit sipas EN-ISO 9001. Murimi punohet me llaç shtrësëhollë: Rërë, Çimento. Në çrëmitë të llogaritë lidhja vertikale në shylla dhe horizontale në tavane me shkumë mbushëse (propen) dhe të gjitha punët e nevojshëm për këtë pozicion, vendosen sipas pozicioneve në projekt.	m <sup>2</sup>	18	8.47 €	1.53 €	10.00 €	180.00 €
Total poz.5							1,680.00 €

<b>6 PUNËT E HIDROIZOLIMIT</b>							
6.1	Furnizimi dhe vendosja e Hidroizolimit të ftohtë "Poliuretani" si mistë e lëngshme që vendoset / lyhet mbi Estrihun para ngjitesit të pllakave në dythemelet dhe në muret perimetrike të sanitareve të WC-ve, në lartësi h=160 cm, materiali duhet të jetë komform standardeit EN ISO 9001 që aplikohet për hidroizolim në hapësira të brendshme. Llogaritë në m <sup>2</sup> .	m <sup>2</sup>	210	2.54 €	0.46 €	3.00 €	672.00 €




6.2	Të bëhet furnizimi me material dhe punimi i hidroizolimit ( me kondor 3mm + 4mm) në dyshemen e aneksit të shtuar. Kjo përfshinë tharjen e dyshemesë, lyerjen me shtresë bazësi dhe shtresë bitumeni. Në pozicion të parashihet edhe shtruzurja e hidroizolimit mbi themele, para se të bëhet muratimi.	m <sup>2</sup>	86	2.37 €	0.43 €	2.00 €	240.00 €
6.3	Të bëhet furnizimi me material dhe punimi i hidroizolimit ( me kondor 3mm + 4mm) në themelet e objektit ekzistues. Kjo përfshinë tharjen e, lyerjen me shtresë bazësi dhe shtresë bitumeni.	m <sup>2</sup>	65	2.12 €	0.38 €	2.50 €	162.50 €
6.4	Të bëhet furnizimi me material dhe punimi i hidroizolimit ( me kondor 3mm + 4mm) në themelet e aneksit të shtuar. Kjo përfshinë tharjen e dyshemesë, lyerjen me shtresë bazësi dhe shtresë bitumeni.	m <sup>2</sup>	48	2.12 €	0.38 €	2.50 €	120.00 €
6.5	Të bëhet furnizimi me material dhe punimi i hidroizolimit ( me kondor 3mm + 4mm) në pllakën e meskirit të aneksit të shtuar. Kjo përfshinë tharjen e dyshemesë, lyerjen me shtresë bazësi dhe shtresë bitumeni.	m <sup>2</sup>	120	2.54 €	0.46 €	3.00 €	360.00 €
Total poz. 6							1,513.30 €

7	<b>PUNËT METALITKE</b>						
7.1	Furnizimi, punimi dhe montimi i gardhit për pjerrinë (rampë) në hyrje të çerdhës nga tubet e Inox-it Ø50mm, gardhit duhet të jetë me dy tuba paralel në horizontale në distancë 30cm. Në çmimi të llogaritur saldimi, rrafshimi, ankerimi dhe lyhen me baze dhe ngjyra RAL 7024 mat në dy shtresa me kompresor dhe të gjitha punët e nevojshëm për kompletimin e këtij pozicioni sipas projektit dhe udhëzimeve për persona me nevojë të veçanta. Llogaris në m <sup>2</sup> .	m <sup>2</sup>	9	33.90 €	6.10 €	40.00 €	360.00 €
